



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve - Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers
Administrata Tatimore e Kosovës - Poreska Administracija Kosova - Tax Administration of Kosovo



ADMINISTRATA TATIMORE e KOSOVËS (ATK)- Divizioni i Ankesave në përbërje të panelit shqyrtues: Bashkim Paçarizi kryesues, Mevlyde Berisha anëtare paneli dhe Ilona Mrasori anëtar njehe rit edhe procesmbajtës, dukë vendosur në çështjen administrative tatimore sipas ankesës së subjektit ta [redacted] me adresë [redacted] në Prizren, ankesa e dorëzuar në Divizionin e Ankesave me datë 13/10/2022 e protokolluar me nr. protokollit 443/22, në mbështetje të nenit 77 të Ligjit Nr. 03/L-222 mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat, kundër Njoftim Rivlerësimeve të lëshuara nga Regjioni Prizreni 2, në seancën dëgjimore të mbajtur me datën: 10/11/2022 në prezencë të palëve: nga tatimpaguesi Nait Kabashi-Kontabilist me autorizim, Bajram Morina-Avokat i tatimpaguesit me autorizim, inspektori Refki Karaxha dhe Udhëheqësi ekipit Milazim Hoxha dhe Ilirjana Sheremeti nga zyra e Avokatit të Tatimpagueseve mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht ankesa Nr.443/2022 e datës 13/10/2022 e subjektit tatimor [redacted] me seli të biznesit adresa Rr.Ismail Kryeziu pn-Prizren, në mbështetje të nenit 132/4 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurat Administrative, në lidhje me nenin 89, paragrafin 2,të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

II. Ndryshohet Njoftim Rivlerësimi për Tatim në të Ardhura të Korporatave për vitin 2021 duke zvogëluar te ardhurat bruto nga 3,601,588.41€ në 3,578,761.80€, zvogëlimi i të ardhurave neto nga 386,404.62€ në 384,121.96€ tatimit në fitim i zvogëluar për 2,282.66€ si dhe Njoftim Rivlerësimin për Tatim mbi Vlerën e Shtuar periudhat 12/2021 duke zvogëluar obligimin tatimor i tvsh se llogaritur nga ai i vlerësuar nga kontrolli nga 13,145.67€ në 9,037.15€, (pa interes dhe ndëshkime),heqja e TVSH-se është 4,108.52€ si dhe zvogëlimi i shitjeve në TVSH periudha 12/2020 sipas kontrollit nga 92,708.04€ në 91,540.55€ diferenca 1167.49€, pjesa e mbetur pas ndryshimeve mbetet obligim për pagesë për tatimpaguesin.

III. Procedura e ankesës nuk ndërprehet sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi, sipas Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

A r s y e t i m

Tatimpaguesi ka dorëzuar ankesë me datë 13.10.2022 në Divizionin e Ankesave ndërkaq Njoftim Rivlerësimet nga Kontrolli dhe Procedurën e ankesës e ka pranuar më datë 14/09/2022, që për rrjedhojë ankesa është parashtruar në afatin ligjor prej 30 ditësh e

përcaktuar me nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222 "Mbi Administratën dhe Procedurat Tatimore".

Vlerësimi i kontrollit:

Kontrolli ka filluar me datë 14.05.2022 dhe përmes formës së kërkesës AU003 – Dokument i Kërkesës së Informatave tatimpaguesi është njoftuar për procedurë kontrolli me datë 17/05/2022, kurse në të njëjtën datë është zhvilluar edhe intervista fillestare.

Objekt kontrolli sipas Raportit të Kontrollit ka qenë; Tatimi Mbi Vlerën e Shtuar periudhat: 01/2020-03/2022 si dhe Tatimi në të Ardhura e Korporatave (CD) për periudhën tatimore 2020-2021.

Gjatë analizimit të evidencave kontabël për periudhat kontrolluese kontrolli ka vlerësuar se tatimpaguesi ka pasur disa parregullsi siç janë trajtimi i avancave, përlllogaritja e kostos së projektit si dhe disa fatura të pa regjistruar dhe këto parregullsi janë trajtuar sipas ligjit Nr.03/L-222 dhe ligjit 05/L-037, Udhëzimi Administrativ 02/2016, gjatë procesit të kontrollit këto parregullsi kanë ndikuar në të hyra shtesë dhe tatim shtesë. [Redacted] i regjistruar me datë 27.06.2000 si biznes juridik me numër unik 810392960 me pronar Alban [Redacted], që nga data 01.08.2002 është deklarues i TVSh-se, ndërsa nga data 01.01.2005 deklarues i TAK-ut, veprimtaria kryesore e këtij biznesi është tregtia e materialit ndërtimor dhe nga Viti 2017 ka filluar edhe me prodhim të betonit të gatshëm. Posedon piken e shitjes në Prizren, një njësi në Rahovec dhe piken e prodhimit të betonit të gatshëm në rrugën transiti në Prizren dhe dyerve dhe dritareve nga PVC për objekte të veta. Hapësirat afariste ku kryhet veprimtaria e biznesit janë pa qira, prona e biznesit pika e prodhimit të betonit të gatshëm dhe njësi në Rahovec, ndërsa për depon ku behet tregtimi i materialit ndërtimor biznesi paguan qira 400.00 €/muajore Muharrem Sopaj-aksionar i biznesit. Të dhëna për blerjet e pronave dhe kryerja e investimeve në piken e prodhimit të betonit të gatshëm janë trajtuar në kontrollin paraprakë, ndërsa gjatë kësaj periudhe të kontrollit ka pasur edhe investim tjera sidomos investime në blerjen e MTH të sektori i prodhimit të betonit të gatshëm. Nga muaji nëntor/2019 ka filluar punimet në ndërtimin e objektit afariste banesor me sipërfaqe total neto prej 6246.42 m² ku nga kjo sipërfaqe lokale do të jene 622 nr. Koefficienti i kreditimit tatimor të t sh-së është 9.96 % ,kostoja e planifikuar për m² 398.52 €, Sopaj ShPK është Investitor-Punë kryes. Në vitin 2021 ka filluar të ndërtoj edhe dy llamella në rrugën Turgut Ozal në Prizren me sipërfaqe netto 5578.78 m² (Llamella I), lokale 573.50 m² dhe banesa 5005.28 m², koefficienti i kreditimit të tvsh-së është 10.28 %, dhe objekti tjetër me sipërfaqe bruto 4411.54 m² (Llamella 2) lokale 419.51 m² dhe banesa 3992.03 m², koefficient kreditimi të tvsh-së 9.51 %.

Tatimpaguesi në ankesën e datës 13.10.2022 konteston Njoftim Rivlerësimeve të rezultuara nga Raporti i Kontrollit, i datës 14.09.2022i dorëzuar sipas formës AU014 me date 10.10.2022, për periudhën kontrolluese 01/2020 deri 12/2021, CD/2019-2021 CM,WM,WR,01/2020-12/2021, subjekti tatimor " Sopaj"Sh.p.k në raportin e kontrollit, të datës 14.09.2022, tatimpaguesit i është rritur qarkullimi për vitin 2021 në shumë prej 71,953.51 Euro dhe për vitin 2020 në shumë prej 1,880.00 Euro, si dhe si pasojë e rritjes të këtij qarkullimi, tatimpaguesi është detyruar të paguaj tatim shtesë në shumë të përgjithshme prej 20,639.70 Euro (pa ndëshkime dhe Interes), dhe këtë në emër të pagesës së tatimit shtesë për TVSH shumën e përgjithshme prej 13,256.19€, kurse në emër të pagesës së Tatimit shtesë në të Ardhurat e Korporatave (TAK-CD), shumën e përgjithshme prej 7,383.5€ (pa ndëshkime dhe interes), me arsyetim se gjëja tatimpaguesi nuk ka deklaruar në mënyrë korrekte shitë-bletjet dhe fitimet për periodën kohore, e Cila ka qenë Objekt i kontrollit. Pas shqyrtimit të Raporti të kontrollit të ATK-së të datës 14.09.2022 dhe krahasimit të gjendjes të reale të regjistruar në librat e tatimpaguesit, si dhe me dokumentacion përkatës financiar burimor, tatimpaguesi konsideron se Raporti i kontrollit i ATK, Nr. 13602/2022, i datës 14.09.2022, me të cilin tatimpaguesi është detyruar që të paguaj tatim shtesë në shumë të përgjithshme prej 20,639.70€(pa ndëshkime dhe

Interes), është pabazuar për këto shkaqe. Një prej çështjeve kryesore kontestuese, është fakti se në rastin konkret, ATK, si bazë për vlerësim të investimeve e ka marrë gjendjen e përshkruar në Para masa, respektivisht në Paralogari, të cilat kanë karakter orientues e jo bazik, pasi dihet se në praktikë paralogaritë dhe para masat, mund të ndryshojnë me rastin e ekzekutimit të punimeve nga vlera reale e tyre, në vartësi të çmimit të tregut dhe llojit të materialit, respektivisht në vartësi të nivelit dhe kualitetit të mallrave furnizues dhe shërbimeve për ndërtimin e Objektivit banesor EMA në Prizren, dhe këtë mesatarisht në vlerën prej rreth +15-20%, apo edhe më tepër. Në rastin konkret tatimpaguesi konsideron se pa bazë ligjore i është rritur vlera e Objektivit të tij banesor, si pasojë e mos-marrjes në konsiderim të dokumentacionit financiar burimor të tatimpaguesit, respektivisht të faktuarve në origjinal të tatimpaguesit, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e Objektivit banesor EMA në Prizren. Lidhur me këtë çështje, tatimpaguesi, përmes Opinioni Kundërshtimit të Draft Raport të kontrollit, të datës 11.08.2022, ia ka bërë me dije inspektorëve të ATK-së, respektivisht ATK-së, se kontrolli financiar duhet të bazohet në faktuarat e tatimpaguesit për furnizim me mallra dhe shërbime, e jo në para masat, apo paralogaritë, të cilat kanë karakter orientues e jo bazik, mirëpo këto argumente valide të tatimpaguesit janë anashkaluar dhe për pasojë ka pasur nxjerrjen e Raportit final të kontrollit, të datës 14.09.2022. i cili nuk ka asnjë ndryshim në raport me Draft Raportin , e datës 11.08.2022, Rivlerësimi i TVSH dhe TAK-CD me kontroll dhe caktimi i qarkullimit shtesë në shumë të përgjithshme prej 20,639.70 Euro, është i pabazuar, pasi :Është bërë në kundërshtim me dispozitat e ligjore në fuqi që e rregullojnë çështjen e deklarimit dhe pagesës së tatimeve, bazuar në faktin se Raporti kontestues i kontrollit ka marrë për bazë gjendjen e çmimeve të paraqitura në Para masat e tatimpaguesit, që konsiderohen si çmime fillestare orientuese, dhe ka anashkaluar gjendjen e prezantuar paraqitur në faktuarat origjinale të tatimpaguesit, të cilat paraqesin vlerën reale të furnizimeve për ndërtimin e Objektivit banesor të tatimpaguesit EMA në Prizren, Vlerësimi i tatimeve dhe caktimi i tatimeve shtesë kontestuese të përmendura më lartë, për Objektivin lëndor të tatimpaguesit, është bërë me gjendje të datës 31.12.2021, dhe ky vlerësim me gjendje të datës 31.12.2021, konsiderohet si vlerësim i parakohshëm, për shkak se nuk është përmbyllur projekti investiv ndërtimor dhe nuk ka ndodhur pranimit teknik i Objektivit banesor EMA në Prizren, i ndërtuar nga tatimpaguesi, në kohën kur është bërë kontrolli financiar, Një vlerësim i tatimeve ligjore për Objektivin banesor të tatimpaguesit EMA në Prizren, ka mundur të bëhet vetëm pas përmbylljes të projektit ndërtimor dhe pranimit teknik të Objektivit banesor EMA në Prizren, që ka ndodhur në muajin prill/2022, në të cilin rast bëhet harmonizimi i Kostos së planifikuar me Koston reale dhe devijimi eventual pasqyrohet në këtë periudhë (këtu periudha Prill/2022), me çka vërtetohet se rritja e qarkullimit, rivlerësimet e tatimeve dhe caktimi i tatimeve shtesë të lartpërmendura për TVSH dhe TAK-CD, sipas Raportit kontestues të kontrollit, të datës 14.09.2022, është bërë në kundërshtim me dispozitat e nenit 8, parag. 1, pika 5 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2016), me të cilat është përcaktuar se : « E ardhura e tatueshme e përcaktuar në nenin 5, parag. 2 , nëparag. 2.2 të Ligjit, trajtohet sipas dispozitave të Udhëzimit (Neni 8, parag. 1 i U.A.), dhe se në periudhën e fundit të përmbylljes së Projektit bëhet harmonizimi i Kostos së planifikuar me Koston reale dhe devijimi eventual pasqyrohet në këtë periudhë (Neni 8, pika 5 e U.A.) Provë:-Raporti i kontrollit i ATIC, Nr. 13602/2022, i datës 14.09.2022, bashkë me Njoftimet për rivlerësim të tatimit të TVSH dhe TAK-CD, të lëshuara sipas bazës së Raportit të kontrollit, Vendimi për pranimit teknik të Objektivit ndërtimor të tatimpaguesit, Nr.04-351/02-188688, i datës 20.04.2022 i lëshura nga Drejtoria Komunale për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit e KK Prizren Ekstrakt të Librave të blerjes dhe të shitjes për periudhën kontrolluese, që lidhen me çështjet kontestuese sipas nevojës Deklaratat tatimore dhe pagesat e tatimit për të gjitha periodat tatimore ,Me leximin e Pasqyrës Tabelore e tatimpaguesit për diferencat e çmimeve në materiale të përdorura për ndërtimin e Objektivit Banesor të tatimpaguesit EMA në Prizren,

të datës 20.09.2022 e cila është përpiluar nga tatimpaguesi, duke u bazuar në dokumentacionin burimor të tatimpaguesit, respektivisht duke u bazuar në Faktuarat origjinale që kanë të bëjnë me ndërtimin e Objektivit banesor EMA në Prizren, vërtetohet se :TVSH -a për vitin 2021 është në shumë prej 8,840.21 Euro, e jo në shumë prej 12,951.63€. Në mes palëve nuk ka qenë kontestues fakti se në kohën e kontrollit, nuk ka ekzistuar Raporti përmbyllës i investimeve , për shkak se investimet në ndërtimin e Objektivit banesor EMA në Prizren, kanë qenë në vijim e sipër dhe të njëjtat kanë përfunduar në muajin Prill/2022, kur ka ndodhur edhe pranimiti teknik i Objektivit banesor EMA në Prizren. Edhe me supozim se tatimpaguesi në kohën e kontrollit ka përfunduar përmbyll Projektin e tij investiv për ndërtimin e Objektivit banesor EMA në Prizren, me gjithë këtë tatimpaguesi konsideron se në rastin konkret, inspektorët e ATK-së që kanë bërë kontrollin, gabimisht dhe pa bazë ligjore me rastin e kontrollit kanë aplikuar metodën indirekte të vlerësimit, andaj detyrimet që i janë caktuar paditësit me aplikimin e metodës indirekte për pagesën e tatimit shtesë në shumë të përgjithshme prej 20,639.70€, nuk kanë bazë ligjore, bazuar në faktin se :Metodat indirekte të kontrollit të cilat gabimisht janë aplikuar në kontrollin financiar të tatimpaguesit, janë të parapara në legjislacionin tatimor në fuqi, respektivisht me dispozitat e nenit 19.3 i Ligjit 03/L-222 për Administratën tatimore dhe Procedurat, vetëm në qoftë se librat dhe regjistrimet e tatimpaguesit kanë humbur apo janë shkatërruar ose ekzistojnë rrethana tjera që bëjnë të pamundur përcaktimin e detyrimit tatimor, Drejtori i Përgjithshëm do të bëjë një vlerësim bazuar në një parashikim ' i cili duhet të bazohet në mjetet, të ardhurat qarkulluese, shpenzimet e prodhimit, shpenzimet krahasuese, dhe metodat tjera drektë dhe indirekte që lidhen me llogaritjen e detyrimit tatimor ", por jo edhe në rastin e tatimpaguesit, bazuar në faktin jokontestues se tek tatimpaguesi nuk ka pasur humbje, apo shkatërrim të librave afaristë dhe regjistrimeve, dhe faktin se në Raportin kontestues të Kontrollit nuk është përmendur asnjë rrethanë, e cila ka bërë të pamundur përcaktimin e detyrimit tatimor, si dhe faktin tjetër jokontestues se tatimpaguesi gjatë kontrollit ka prezantuar dokumentacion valid të parapara me ligjin në fuqi, lidhur me ndërtimin e Objektivit Banesor EMA në Prizren, Me caktimin e tatimit shtesë të lartpërmendur, tatimpaguesit i shkaktohet dëm i konsiderueshëm material, si pasojë e mos-marrjes në konsiderim nga ana e inspektorëve që kanë bërë kontrollin vlerën e tregut të definuar me ligjin në fuqi në Kosovë, me çka vërtetohet se inspektorët që kanë bërë kontrollin kanë vepruar në kundërshtim me Dispozitat e nenit i, nën paragrafi. 1.45 i Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën dhe Procedurat, me të cilat është përcaktuar se :Vlerë e tregut — është çmimi me të cilin mallrat dhe shërbimet e ngjashme të të njëjtës cilësi dhe sasi do të mund të shiteshin në një transaksion tregtar të paanshëm, Dispozitat e nenit 24, paragraf.2 i Ligjit Nr. 03/L- 146 për TVSH, me të cilat është përcaktuar se Vlera e hapur e tregut " nënkupton shumën e plotë që duhet ta paguaj konsumatori në shkallën e njëjtë të tregut në të cilin ndodh furnizimi i mallrave dhe shërbimeve, nën kushtet e konkurrencës së barabartë, për furnizuesin nën mbizotërimin e tregut brenda Kosovës ku është bërë furnizimi, në mënyrë që të marr mallrat ose shërbimet në fjalë në atë moment " dhe Dispozitat e nenit 8, paragraf 1, 2 dhe 3 të Ligjit Nr. 03/1=-114 për TVSH , me të cilat është përcaktuar se: Vlera e tatueshme e furnizimit të tatueshëm në Kosovë përbën pagesën (konsideratën) e përgjithshme të paraparë për atë furnizim. Raporti i kontrollit është i pabazuar edhe në pjesën ku tatimpaguesit nuk i është marruar për bazë blerja sipas Faktuarës Nr. H-2019/0299, të datës 07.01.2020, të lëshuar nga shitësi furnizuesi i tatimpaguesit : HSK , L.L.C., me seli në Prishtinë, me NUI : 810871394, me arsyetim se ky furnitor gjëja nuk e të regjistruar në librat e tij Faktuarës e lartpërmendur, bazuar në faktin se tatimpaguesi e ka regjistruar dhe paguar këtë frakturë dhe se nuk është përgjegjësi e tatimpaguesit regjistrimi apo mos-regjistrimi i Faktuarës të lartpërmendur nga ana e shitësit : HSK , L.L.C., me seli në Prishtinë, me NUI : 810871394. Bazuar në argumentet ligjore dhe faktike të përmendura në këtë ankesë, si dhe në provat të cilat i bashkëngjiten kësaj ankese vërtetohet se Raporti i

kontrollit është përpiluar me shkelje ligjore të shumta, se Raporti i kontrollit nuk është bazuar në ligj dhe në prova vali de, respektivisht në dëshmi materiale vali de, me të cilat ATK do të arsyetonte caktimin e qarkullimit shtesë dhe tatimit shtese, dhe se ATK e ka detyruar tatimpaguesin të paguaj tatim shtesë për TVSH dhe TAK-CD, si pasojë e rritjes fiktive të qarkullimit, e cila rritje fiktive e qarkullimit, ka ardhur si pasojë e mos-marrjes në konsiderim të faturave origjinale të tatimpaguesit nga e inspektorëve që kanë bërë kontrollin, të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e Objektivit banesor EMA në Prizren, dhe të cilat paraqesin vlerën reale të furnizimeve për ndërtimin e Objektivit banesor EMA në Prizren, me çka tatimpaguesi është dëmtuar materialisht pa bazë ligjore. Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar si më lartë vërtetohet : se inspektorët e ATK-së, të cilat kanë bërë kontrollin sipas Raportit të tyre të kontrollit, të datës 14.09.2022, kanë vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë gjendjen faktike, se kanë bërë shkelje të rënda të dispozitave ligjore, se kanë aplikuar gabimisht të drejtën materiale në dëme të tatimpaguesit, se ka shqiptuar pa bazë ligjore ndëshkime dhe interes, se kanë detyruar tatimpaguesin të paguaj Tatime shtesë pa bazë ligjore, kështu për këto shkaqe, tatimpaguesi i propozon Departamentit për shqyrtimin e ankesave të ATK-së, që lidhur me shqyrtimin e kësaj anese të tatimpaguesit, të caktoj seancë dëgjimore, dhe që pas mbajtjes të seancës dëgjimore, shqyrtimit të shkresave të lëndës dhe pretendimeve të tatimpaguesit të merret një vendim i drejt.

Divizioni i Ankesave në bazë të nenit 95 të Ligjit Nr. 05/L – 031 Mbi Procedurat e Përgjithshme Administrative ka organizuar seancën e dëgjimit më datë 10.11.2022, në të cilën të pranishëm ishin përfaqësuesi i biznesit si dhe të gjitha palët e ftuara në mënyrë të rregullt.

Përfaqësuesi i biznesit në të drejtën e fjalës theksoj se çështja kryesore të cilën e kontestojmë është mos marrja në konsideratë të shpenzimeve të ndërtimit të objektit [redacted], kontrolli është bazuar në para masa dhe parallogarit dhe jo në faturat blerëse të cilat i kemi prezantuar, objekti ka dy lla mella, gjatë procesi të kontrollit Inspektorit tatimor ja kemi prezantuar të gjitha dëshmitë burimore të furnizimeve dhe jo të bëhet vlerësimi përmes metodave indirekte. Në momentin e kontrollit nuk ka qenë i përfunduar projekti, certifikata e pranimit teknik i është bashkangjitur dosjes e cila është lëshuar me datë 20.04.2022. Sipas legjislacionit tatimor harmonizimi i shpenzimeve duhet të bëhet në përfundim të projektit.

Faturat e furnitorit [redacted] nuk është pranuar me arsyetimin se shitësi nuk e ka regjistruar në librat kontabël, për shkak të një gabimi teknik të inxhinieri nuk janë ndryshuar vlerat e parametrave dhe para llogarive pasi që e kemi marr lejen për vazhdimin e objektit edhe për I kat. Gjatë procesit të kontrollit inspektorit tatimor i ka marr çmimet e materialit shumë të larta deri në 50-60%.

Inspektori në të drejtën e fjalës theksoj se çmimet e për llogarive janë marr pasi që objekti nuk ka përfunduar, çmimet e materialit kanë qenë në baze të çmimeve të prezantuara në para masa dhe parallogarite tatimi në fitim tatimpaguesi ka bërë deklarinimin jo të sakte dhe të gjitha rregullimet i kemi bërë. Fatura e furnitorit HSK është regjistruar në janar 2020, kurse udhëheqësi i ekipit theksoj se gjatë ndërtimit të objektit ka bërë furnizime edhe nga biznesi i vet dhe faturimet i ka bërë me çmime më të ultë ndërsa deklarinimet i ka bërë sipas çmimeve të para masave.

Administrata Tatimore – Divizioni i Ankesave, pas shqyrtimit të pretendimeve në ankesë, dëgjimit të palës ankuese në seancën dëgjimore, administrimit dhe vlerësimit të gjitha provave në shkresat e lëndës, paneli shqyrtues vlerësoj se ankesa e subjektivit në procedurë është bazuar pjesërisht.

Divizioni i Ankesave pas vlerësimit të provave materiale në shkresat e lëndës si: Raporti i Kontrollit datë 14/09/2022, Njoftim Rivlerësimeve pas kontrollit, Fletave të Punës së Kontrollit, vlerësimit të provave të bashkangjitura ankesës së dorëzuar me shkrim dhe analizimit të pretendimeve ankimore vendos se ankesa e tatimpaguesit është pjesërisht e bazuar.

Dispozitivi i këtij Vendimi të Divizionit të Ankesave është i mbështetur në faktet në vijim: Kontestin e tatimpaguesit se me procedurë të kontrollit mungesat e evidentuar të materialit ndërtimor janë trajtuar me çmime të para masave dhe par llogarive çmime te cilat kanë ndryshuar në momentin kure ka filluar te ndërtohet objekti Ila mella "EMA". Ndërtimi i objektit Ila mella "EMA" në Prizren është planifikuar sipas para masave dhe par llogarive të ndërtohet B+P+7 dhe gjatë punimeve të ndërtimit është ndryshuar plani i ndërtesës ku është shtuar edhe një kate duke u bërë B+P+8 (është shtuar edhe 1 kat i ndërtesës), nga muaji nëntor/2019 ka filluar punimet në ndërtimin e objektit afariste banesor me sipërfaqe total neto prej 6246.42 m² ku nga kjo sipërfaqe lokale do te jene 622 nr. Koeficienti i kreditimit tatimor të tvsh-së është 9.96 % ,kostoja e planifikuar për m² 398.52€.

Gjate procesit te kontrollit është konstatuar mungesë te materialit ndërtimor pasi që biznesi posedon depo te materialit ndërtimor dhe per ndërtimin e objektit biznesi ka bërë furnizim për vetveten me çmime te njëjta ashtu siç bën furnizime per bizneset tjera andaj me proces te kontrolli është konstatuar se është si rezultat i katit shtesë i cili është shtuar gjate procesit të ndërtimit dhe kontrolli këtë mungesë e ka trajtua si shitje me çmime sipas para masave dhe para llogarive e jo sipas çmimeve te faturimit te cilat biznesi i ka faturuar kjo mungesë e materiali ndërtimor i cili është konstatuar si mungesë ne depon ndërtimore është: beton i gatshëm 575.5 metër kub beton çmimi sipas para masave dhe para llogarisë 80 €,hekur kg 41740.4 kg çmimi sipas para masave dhe para llogarisë 0.71€,Blloka 12 copë 34188 copë çmimi sipas para masave dhe para llogarisë 0.27€ dhe sipas kësaj kontrolli ka konstatua qarkullim shtesë pa tvsh 71,954.51euro x 18% = 12,951.63€, qarkullimi shtesë me tvsh është 84,906.14€ kurse sipas kontestit të tatimpaguesit këtë mungesë të materialit ndërtimor pretendon që duhet të trajtohet si qarkullim shtesë sipas çmimeve të faturimit te cilat janë beton i gatshëm 575.5 metër kub beton çmimi sipas faturimit 51€,hekur kg 41740.4 kg çmimi sipas faturimit 0.53€,Blloka 12 copë 34188 copë çmimi sipas faturimit 0.19€ dhe sipas kësaj qarkullim shtesë pa tvsh 49,128.41euro x 18% = 8,843.11euro, qarkullimi shtesë me tvsh është 57,968.63€.

Divizioni i ankesave sa i përket këtij kontesti vlerëson se mungesa e konstatuar me proces të kontrollit duhet te trajtohet me çmime sipas faturimit te cilën biznesi ka bërë furnizim per vetveten dhe në bazë te faturimit shifet se furnizimi është bere me çmime sipas çmimeve ne treg kjo është argumentuar edhe ne bazë të faturave te cilat janë ne dosje andaj si rezultat te kësaj kemi zvogëlim te qarkullimit shtesë nga 71,954.51€ në 49,128.41€ ne TVSH 12/2021 efekti e këtij ndryshimi është me kontroll tvsh 12,951.63€ kurse sipas divizionit të ankesave tvsh është 8,843.11€ diferenca është 4,108.52€,këto ndryshime do te reflektojnë ne uljen e qarkullimit shtesë ne TVSH periudha 12/2021 nga 73,031.52€ në 50,205.42€ si dhe uljen e tvsh se llogaritur nga 13,145.67€ në 9,037.15€, si dhe ne deklaratën vjetore CD/2021 uljen e te ardhurave bruto nga 3,601,588.41 në 3,578,761.80€ diferenca 22,826.61€ dhe efekti ne tatim fitim është ulje te ardhurave neto nga 386,404.62€ në 384,121.96€ diferenca 2,282.66€. Kurse sa i përket mospranimit te faturës se blerjes nga biznesi HSK të cilën faturë me nr. H-2019/0299 e datës 07.01.2020 dhe procedura kontrollit e ka trajtua si shitje pasi qe shitësi nuk e ka pasur te deklaruar ketë faturë ky ka qen arsytimi i kontrolli është që këtë faturë të blerjes ne te njëjtën kohë e ka trajtua si shitje me një marzhë prej 18.36% vlera e faturës 986.39 *18.36% qarkullim shtesë pa tvsh 11167.49€.

Me procedurë te kontrolli është ne periudhën dhjetor/2020 do te ketë shitje shtesë nga fatura e blerjes e pa deklaruar si blerje nga biznesi HSK,në vlerë ;986.39 € pa tvsh * 18.36% marzha

mesatare bruto e marre nga kalkulimet e biznesit qe na jep vlere te tatueshme prej 1,167.49€ qarkullim shtesë.

Divizioni i Ankesave ka verifikuar këtë fature e cila është fature e shërbimit për të cilën biznesi HSK ka kryer shërbim për biznesin "██████████" dhe shërbimi është trajnim apo informim për sigurinë në punë të punëtoreve të këtij biznesi, dhe pas verifikimeve qe janë bere kjo fature është e regjistruar tek shitësi dhe tek blerësi edhe me procedure të kontrolli është pranuar si blerje pa tvsh ashtu siç ka qen e deklaruar nga tatimpaguesi andaj Divizioni i ankesave vlerëson se kjo faturë është e pranuar ne libër të blerjes por jo edhe tvsh e zbritshëm pasi që vet tatimpaguesi e ka te regjistruar në deklaratë tek blerjet pa tvsh të zbritshëm andaj Divizioni i Ankesave konstaton se kontrolli në mënyrë jo të drejt e ka trajtuar si shitje dhe efekti i kësaj fature është zvogëlim i shitjeve për periudhën 12/2020 në vlerën 1,167.49€ vlere e tatueshme dhe tvsh-ja 210.14€, kurse efekti në deklaratën vjetore nuk kemi pasi që është pranuar si blerje/shpenzim, Divizioni i Ankesave vlerëson se veprimtaria e biznesit nuk kryen shërbime për të trajtuar një faturë të blerjes/shërbimit si shitje dhe kjo e argumenton me se mire veprimtaria e biznesit dhe fatura e blerjes qe nuk kanë lidhshmëri njëra me tjetrën, andaj edhe fatura e blerjes i plotëson kriteret e faturës sipas Udhëzimit Administrativ 15/2010 Neni 20 paragrafi 1 i cili thotë: *Kërkesat për faturim për transaksionet në mes të personave të tatueshëm: Një faturë me TVSh, e njohur si faturë tatimore, kërkohet të lëshohet nga të gjithë tatimpaguesit të cilat janë të detyruar të paguajnë TVSh për secilin transaksion në të cilin përfaqësohet furnizimi i mallrave apo shërbimeve për personin tjetër të tatueshëm (personi i cili është i regjistruar në TVSh, apo kërkohet të regjistrohet në TVSh), qoftë ai person tjetër shoqëri tregtare, që do të kalojë shërbimin apo mallrat te personi tjetër, apo është konsumatori përfundimtar. Fatura duhet të lëshohet në së paku në dy kopje origjinale, një për shitësin dhe një për klientin apo blerësin,* andaj fatura i plotëson kushtet për tu pranuar si faturë e blerjes per çështje të deklaratës vjetore CD/2020 përderisa edhe biznesi qe e ka lëshuar faturën e ka te deklaruar ne libër te shitjes, andaj kjo fature nuk është e paguar por është në llogarinë e pagueshme tek biznesi "██████████".

Divizioni i Ankesave vlerëson se sa i përket ndërtimit te objektit tek kontratat afatgjate të ndërtimit shume qartë e përcakton udhëzimi administrativ 02/2016 neni 8 e ardhura nga projekti dhe kontratat afatgjate e ndërtimit paragrafi 5 thotë: *Në periudhën e fundit të përmbylljes së projektit bëhet harmonizimi i kostos së planifikuar me koston reale dhe devijimi eventual pasqyrohet në atë periudhë,* andaj D.A vlerëson se tatimpaguesi duhet ti bej rregullimet në fund të projektit ku sipas certifikatës se pranimit teknik objekti ka përfunduar në periudhën 04/2022.

Divizioni i Ankesave në bazë të legjislacionit tatimor, ballafaqimit dhe ekzaminimit të provave materiale në shkresat e lëndës në këtë çështje administrative tatimore, vendos se ankesa e subjektit në procedurë është pjesërisht e bazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi bazuar në nenin 77.2 të Ligjit Nr. 03/L-222, "Për Administratën Tatimore dhe Procedurat", dhe nenin 132/2 të Ligjit Nr. 05/L-031 Për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

TOLLA E FINANCËS

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi bazuar në Nenin 3 të Ligjit Nr. 04/L-102 “Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat” 03/L - 222, tatimpaguesi i pakënaqur ka të drejtë që brenda afatit (30) ditësh, nga dita e pranimit të Vendimit të Divizionit të Ankesave, ta kundërshtojë këtë Vendim tek Divizioni Fiskal i Departamentit Administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë.

DIVIZIONI I ANKESAVE NË PRISHTINË
Nr. 443/2022 datë 12/12/2022

Vendimi t’iu dorëzohet :

1. Tatimpaguesit
2. Administratës Tatimore

Udhëheqës i Divizionit të Ankesave
Skender Krasniqi

Kryesuesi i panelit shqyrtues
Bashkim Paçarizi

